



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.02.2019

Ref.: 184/KSD

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Neni 7 dhe Neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa për riakreditim/akreditim e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik, Nr.1439/18, datë 29.10.2018 për programin e studimit:
 - Arkivistikë, MA, 120 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik (tash e tutje Fakulteti Filozofik) ka parashtruar kërkesë (Nr.1439/18, datë 29.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim/riakreditim të tri programeve të studimit si në vijim: Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci, MA, 120 ECTS; Psikologji komuniteti dhe klinike, MA, 120 ECTS, dhe Arkivistikë, MA, 120 ECTS.

Bazuar në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Fakultetit Filozofik, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1. 2 të këtij Neni, ku thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së", erdhi në përfundim se programi i studimit, Arkivistikë, MA, 120 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Sipas Nenit 26, pika 5. 3. 4 e UA për Akreditim (15/2018, datë 28. 09. 2018): “Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.

- Për programin e studimit: *Arkivistikë, MA, 120 ECTS*, bartës të këtij programi Fakulteti Filozofik ka paraparë: Ibrahim Gashi (PhD në Shkencat e Historisë), dhe Muhamet Qerimi (PhD në Shkencat e Historisë).

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: “për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”. Programi i studimit *Arkivistikë, MA, ka 120 ECTS*, dhe rrjedhimisht duhet të ketë të paktën dy persona me gradën akademike PhD, nga fusha e programit të studimit.


Pas kontrollimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Fakulteti Filozofik, u konstatua që Ibrahim Gashi, dhe Muhamet Qerimi janë PhD në Shkencat e Historisë, dhe të njëjtit nuk mund të jenë bartës në programin e studimit *Arkivistikë, MA*, për shkak se nuk i përkasin fushës së arkivistikës, siç përcaktohet në pikën 5.3.4 të nenit 26 të UA për Akreditim.

Bazuar në faktet e prezantuara dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Arkivistikë, MA, 120 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë